AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP), TM1 2024

31.05.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e parë (TM1) 2024, viti bazë 2010=100.

Çmimet e importit më të larta në TM1 2024 sesa në TM1 2023

Indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë pati ngritje për 2.5 % në TM1 2024, krahasuar me TM4 2023. Ndërkaq, krahasuar TM1 2024 me TM1 2023 çmimet e importit u ngritën në një mesatare prej 2.4 %.



Tremujori i parë 2024 / Tremujori i katërt 2023 2.5 %

Çmimet e importit në Kosovë patën ngritje në një mesatare prej 2.5% në TM1 2024, krahasuar me TM4 2023. Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin lëkura dhe artikujt e saj (14.5%), vajrat ushqyese (10.1%), te instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinal, muzikorë dhe mekanizmat e orës (7.9%), produktet bimore(6.1%) etj.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve, druri dhe artikujt e tij (-0.3%).

Tremujori i parë 2024 - Tremujori i parë 2023 2.4 %

Çmimet e importit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 2.4 % në TM1 2024, krahasuar me TM1 2023. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës (14.0 %), tekstili dhe artikujt e tekstilit (11.2%), produktet bimore (10.4 %), mjetet e transportit (9.6%), lëkura dhe artikujt e saj (7.3%) etj.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorit te vajrat ushqyese (-6.4%), metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-3.4%), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-3.2%), druri dhe artikujt e tij (-2.3%), produktet minerale (-1.5%), dhe artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (-1.4%).

Ndryshimet tremujore dhe vjetore në % sipas sektorëve

Kodi	Grupi	Pesha	TM1- 2024 2010 =100	TM1 - 2024 TM4-2023	TM1 - 2024 TM1 - 2023
01-21	**IÇIMP - Gjithsej**	**1000**	**166.0**	**2.5**	**2.4**
01	Shtazët e gjalla; produktet e shtazëve	38	184.0	5.1	1.3
02	Produktet bimore	50	369.6	6.1	10.4
03	Vajrat ushqyese	10	219.2	10.1	-6.4
04	Artikuj ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani	131	137.0	0.3	6.1
05	Produktet minerale	147	232.3	5.4	-1.5
06	Produktet e industrive kimike	80	128.1	1.6	1.2
07	Plastika,kauçuku dhe artikujt e tyre	64	156.5	1.9	-3.2
08	Lëkura dhe artikujt e saj	2	118.3	14.5	7.3
09	Druri dhe artikujt e tij	26	181.2	-0.3	-2.3
10	Letrat dhe artikujt e saj	16	134.6	1.1	1.4
11	Tekstili dhe artikujt e tekstilit	44	101.6	1.2	11.2
12	Këpucët	12	155.3	0.2	4.8
13	Artikutj e gurit, të llaçit, produktet e keramikës dhe te qelqit	34	194.0	0.3	-1.4
14	Margaritarët, gurët e çmuar, metalet, etj.	:	:	:	:
15	Metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë	100	168.4	0.3	-3.4
16	Paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike	118	123.5	2.3	1.2
17	Mjetet e transportit	88	152.0	3.3	9.6
18	Instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës	10	127.3	7.9	14.0
19	Armët dhe municioni	:	:	:	:
20	Artikujt e ndryshëm të prodhuar	28	132.5	3.0	2.5
21	Veprat e artit	:	:	:	:

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e parë TM1- 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation